

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Integrimi në BE, mes polarizimit politik dhe mungesës së transparencës
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/05/16/integrimi-ne-be-mes-polarizimit-politik-dhe-mungeses-se-transparences/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:16:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 maj 2026, 06:13:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f9d015b83f658a8b976a233722ac7f1773967d40c2371d492310f3d80e8c1f7d
TEKSTI	289eb1dde78319be0a950b8d0677e98bd7590da4efb874df30d86d7605d18145
PAMJA	1472975800288c95ad6b76fd84cdc0c2d107dd1decc7222836e5bcfbe1b7906b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b07a1f0166409d82670357ca2de2efbb83fee4a76c9701808d4eb2a93e46d347
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b07a1f0166409d82670357ca2de2efbb83fee4a76c9701808d4eb2a93e46d347>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Analiza

Integrimi në BE, mes polarizimit politik dhe mungesës së transparencës

Kuvendi i Shqipërisë u përfshi të enjten nga debatet mbi transparencën e qeverisë për ecurinë e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, por në finale mazhoranca dhe opozita bashkuan votat për një rezolutë që mbështeste këtë proces. Edhe ekspertë të integrimit dhe komunikimit vlerësojnë se procesi nuk ka transparencën e duhur dhe as përfshirje të gjithë aktorëve të shoqërisë.

nga Blerina Gjoka — 4 months më parë në Analiza, Artikull kryesor, Bashkimi Evropian

Koha e leximit: 5 min lexim

AA 0



Ambasadori i BE-së Silvio Gonzato, duke biseduar me deputetët e PD-së Jorida Tabaku dhe Gazment Bardhi

Qeveria shqiptare synon që brenda këtij viti të mbyllë 10 nga 33 kapitujt e negociatave me Bashkimin Evropian dhe pse procesi duket sikur është në ngjercë deri në një përgjigje të vendeve anëtare që vlerësojnë ecurinë e deritanishme të tij – vendimmarrje që sipas qeverisë nuk ka një afat kohor se kur mund të ndodhë.

Në politikën e brendshme procesi i integrimit vijon të shkaktojë debat politik dhe kritika për mungesë transparence dhe përvetësimi të procesit nga qeveria.

Kuvendi përfshiu të enjten në rend të ditës votimin e një rezolute parlamentare mbështetëse për procesin.

Por para se ta votonin me konsensus me 114 vota mazhoranca dhe opozita u përfshin në debat për mënyrën se si qeveria po e trajton procesin duke theksuar se më shumë se sa teknik ai është politik dhe lidhet me vlerat e standardet demokratike.

Debat i politik u bazuar në një raport të dorëzuar nga qeveria më herët në Kuvend, ku bëhej një tablo teknike e negociatave për çdo kapitull dhe masave të marra për përmbushjen e kritereve dhe hendeqeve të konstatuara nga Brukseli.

Kryetari i grupit parlamentar demokrat Gazment Bardhi akuzoi qeverinë për "hipokrizi" ndaj procesit të integrimit dhe përdorimin e tij për propagandë elektorale.

"Në letrat dhe raportet e Edi Ramës gjithçka duket perfekte" - tha ai duke shtuar se "Europa nuk është propaganda për reformën në drejtësi. Europa është barazia përpara ligjit, të cilën Edi Rama e shkeli me këmbë për Belinda Ballukun".

Ai e cilësoi raportin e qeverisë si një përpjekje të qeverisë për shitur stabilitetin politik si zëvendësim të demokracisë. "Po përpiqet t'i thotë Europës: mbyllni sytë përpara korrupsionit, kapjes së shtetit, presionit mbi mediat, mungesës së zgjedhjeve reale dhe në këmbim do t'ju japim stabilitet", tha Bardhi.

Deputetë të tjerë të opozitës kërkuar më shumë transparencë nga qeveria për negociatat duke vënë theksin tek mbajtja 'sekret' e pozicionit negociues të saj me BE-në dhe përfshirjen e opozitës në proces.

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026

Edhe për ekspertë të shoqërisë civile ky proces nevojitet të jetë më transparent dhe gjithëpërfshirës.

"Nuk ka pasur transparencën e nevojshme për një proces kaq të rëndësishëm", i tha BIRN Gledis Gjipali, drejtor ekzekutiv i "European Movement Albania"

Sipas tij, çështja e 'pozicioneve negociuese' është shumë e rëndësishme të jetë transparente.

"Jo vetëm kanë qenë konfidenciale gjatë hartimit por dhe pas miratimit të tyre vazhdojnë të jenë të tilla, gjë që pengon grupet e interesit apo politikën për të analizuar dhe për të dhënë kontributin që të jenë vërtet pozicione kombëtare të Shqipërisë në proces", shton ai.

Kjo mungesë transparencë e bën procesin që të mos jetë i hapur ndaj aktorëve të tjerë vlerëson Gjipali.

Për sa i përket momentit ku ndodhet aktualisht procesi i negociatave ku pritet miratimi i Raportit të Vlerësimit të Përkohshëm të Standardeve një mekanizëm i njohur si IBAR ose një lloj 'provimi i ndërmjetëm' për ecurinë e negociatave, Gjipali thotë se transparenca nuk varet nga pala shqiptare.

Sipas tij, "ngelet në dorën e vendeve anëtare nëse duan të bëjnë publike pengesat që ekzistojnë".

Kërkesat e organizatave ndaj qeverisë që pozicionet negociuese të konsultoheshin ose të paktën të bëheshin publike kanë rënë në vesh të shurdhër, ndërkohë që ato vijnë të mos jenë publike dhe pas çeljes së negociatave për çdo grup-kapitull, ashtu siç mbeten të panjohura dhe shumë aspekte të tjera të negociatave që bëhen pas dyerve të mbyllura. Ndërsa Komisioni Europian e ka publikuar dokumentin e pozicioneve negociuese me të cilat ka hyrë në negociata me Shqipërinë.

"Kjo krijon një asimetri informacioni", thotë Blerjana Bino, që drejton Qendrën për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV), duke shtuar se "pozicionet negociuese nuk janë dokumente thjesht teknike. Ato tregojnë angazhimet reale të vendit, reformat që marrin prioritet, fushat ku kërkohen periudha tranzitore, kostot institucionale dhe mënyrën si preken qytetarët, bizneset, institucionet dhe grupet e interesit".

Për Binon gjithashtu është shqetësuese për shoqërinë civile dhe publikun mungesa e transparencës së procesit të integritetit, sidomos në kushtet e metodologjisë së re dhe të një procesi të përsheptuar.

Përveç dokumentacionit, sipas saj, mungon edhe gjurmueshmëria e procesit që publiku të di, sipas saj, se "kush është konsultuar, cilat komente janë marrë në konsideratë, cilat janë refuzuar dhe pse?".

"Pa këtë, konsultimi rrezikon të mbetet formal dhe kontributi i shoqërisë civile, ekspertëve apo grupeve të interesit nuk përkthehet domosdoshmërisht në ndikim real", i tha Bino BIRN-it.

Në këtë kontekst Bino vlerëson se roli i Kuvendit dhe strukturave të posaçme të tij duhet të forcohet si institucion monitorues i procesit.

"Kuvendi duhet të ketë informacion të plotë, debat të rregullt mbi kapitujt dhe grup kapitujt, dhe hapësira ku shumica, opozita, shoqëria civile dhe ekspertiza e pavarur mund të ndjekin jo vetëm miratimin e ligjeve, por edhe cilësinë dhe zbatimin e reformave".

Ndryshe nga Gjipali, Bino beson se dhe për mekanizmin e IBAR qeveria shqiptare mund të bënte transparencë pavarësisht natyrës që ka procesi i vendimmarrjes nga vendet anëtare.

"Nuk themi dot automatikisht termin "ngërç", sepse kjo kërkon informacion të plotë mbi komunikimin mes qeverisë dhe institucioneve të BE-së, që nuk e kemi, por padyshim ka një moment paqartësie që kërkon shpjegim publik më serioz", thotë ajo.

Sipas Binos, IBAR është një dokument shumë i rëndësishëm i cili prek ritmin dhe besueshmërinë e të gjithë procesit.

Bazuar në këtë rëndësi ajo këmbëngul që "qeveria duhet të shpjegojë ku ndodhet procesi, cilat janë pritshmëritë e BE-së, çfarë është përmbyshur, ku ka vonesa dhe cilat janë masat korrigjuese".

Ekspertët vlerësojnë gjithashtu se procesi duke pasur karakter kombëtar do të duhej të ishte më gjithëpërfshirës ndaj gjithë aktorëve të shoqërisë dhe se ai nuk duhej trajtuar nga qeveria në mënyrë thellësisht teknike duke lënë jashtë komponentin politik të tij.

"Mendoj se momente të caktuara procesi i integritetit trajtohet në mënyrë të ngushtë në aspektin krejtësisht teknik të tij, duke lënë jashtë çështje që kanë impakt të brendshëm politik të cilat lihen jashtë për të ulur presionin politik dhe për të shmangur përgjegjësitë politike mbi këtë proces"- thotë Gjipali.

Kërkesën e opozitës për të pasur një rol parlamentar më të fortë në proces ai e sheh si të justifikuar dhe në linjë me vetë kërkesën e BE-së për dialog dhe diskutim konstruktiv për procesin në Kuvend.

Por ai shton se parlamenti duhet ta trajtojë procesin ligjbërës dhe mbikëqyrës të tij në mënyrë më transparente dhe më gjithëpërfshirëse.

"Palët janë fokusuar më shumë tek konflikti në lidhje me bashkëpronësinë e procesit" se sa tek bërja e një procesi të hapur ndaj gjithë shoqërisë shqiptare", përfundoi Gjipali.

Etiketa: Bleriana Bino Gazment Bardhi Gledis Gjipali